

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 129 Kol.
Nr. 1219 Rep.



Prot 290
dt 30.03.07

KONTRATE
SHITJE AKSIONESH
(TRANSFERIM)

Sot me date 30.03.2007 (dymije e shtate), ditën e premte, para meje Noteres ARTEMISA MECAJ, Notere e Dhomes se Noterise Tirane, me seli ne rrugen e Duresit, Numer 79, Tirane, u paraqiten personalisht shtetasi shqiptar, me cilesine e Shitesit dhe shtetasi shqiptar, me cilesine e Bleresit, te cilet me kerkuan redaktimin e kesaj Kontrate Shit-Blerje Aksionesh me termat e meposhtem:

SHITESI : Dervish Haskaj i biri i Ademit, datelindje 08/03/1944, lindur ne Tepelene, banues ne Tirane, lagja nr.2., Rr. Arkitekt Kasemi, p.1., shk.1., ap. 9., shtetas shqiptar, person madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, zoterues i 4.9 % (kater pike nente perqind) te Aksioneve te Shoqerise Tregtare "ATLANTIK sh.a.", Tirane, me Nr. Z1541227 Pasaporte.

BLERES : Dritan Celaj, i biri i Rrapos, lindur ne Berat me 27/08/1968, banues ne Tirane, ne Rrugen « Themistokli Germenji », 3/1., shtetas shqiptar, person madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, me Nr. 0563786 te Pasaportes.

OBJEKTI : Shitja 4,9% e (kater pike nente per qind) te Aksioneve, te Shoqerise Tregtare "ATLANTIK" Sh.A e barabarte me 1470 (njemije e katerqind e shtatedhete) aksione.

Baza Ligjore : Neni 128 i Ligjit 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe neni 705 e vijues i Kodit Civil, Ligji 7829, date 01.06.1994 "Per Noterine", Ligji 7667, date 28.01.1993 "Mbi Rregjistrin Tregtar dhe Formalitet qe duhen plotesuar ne te,".

PERMBAJTJA E KONTRATES

Shoqeria Tregtare "Atlantik" Sh.a. eshte rregjistruar ne Rregjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane me Vendimin Nr 25720, date 02.05.2001.

Kapitali themeltar fillestar i kesaj Shoqerie ne momentin e themelimit, pasqyruar ne Akt Themelimin dhe Statutin e kesaj Shoqerie, rezulton

100.000.000 leke (njqind million) Leke, i perbere nga 10.000 aksione me vlere nominale 10.000 leke per aksion.

Me vendimin numer 25720 /3, date 16.04.2003 te Gjykates se rrethit Tirane eshte pasqyruar perqindja e zoterimit dhe numerit te aksioneve nga aksioneret e shoqerise "Atlantik"sha perkatesisht si me poshte

1. **Dritan Celaj** zoterues i 95.1% te aksioneve te kesaj Shoqerie, e barabarte me 9510 aksione
2. **Dervish Haskaj**, zoterues i 4.9 % te aksioneve te kesaj shoqerie e barabarte me 490 aksione.

Me vendimin numer date 09.08.2005 te Asamblese se jashtezakonshme te aksionereve te Shoqerise "Atlantik"sha eshte miratuar zmadhimi i kapitalit te shoqerise ne vleren shumen 300.000.000 (tre qind milion) Leke nepermjet emetimit te 20.000 (njetzmije) aksioneve te reja te cilat kane vlere nominale 10.000 (dhjete mije) leke per cdo aksion. Vlera totale e aksioneve ne Shoqerine "Atlantik"sha eshte 300.000.000 leke e perbere nga tridhjete mije aksione me vlere nominale 10.000 leke per aksion.

Zoterimi i aksioneve ne shoqerine "Atlantik"sha eshte si me poshte :

Dritan Celaj zoterues i 95.1% (nentedhjete e pese pike nje perqind) te aksioneve te kesaj Shoqerie e barabarte me 28.530 (njetete e tete mije e peseqind e tridhjete) aksione.

Dervish Haskaj, zoterues i 4.9 % (kater pike nente per qind) te aksioneve te kesaj shoqerie e barabarte me 1470 (njemije e katerqind e shtatedhjete) aksione.

Me Vendimin te Gjykate se rrethit Tirane numer 25720/7, date 23.09.2005 eshte kryer rregjistrimi i zmadhimit te kapitalit ne shumen 300.000.000 (tre qind milion) Leke dhe pas ketij zmadhimi te kapitalit zoterimi i aksioneve ne kapitalin e shoqerise "Atlantik" sha nga aksioneret Dritan Celaj dhe Dervish Haskaj eshte si me poshte :

1. **Dritan Celaj** zoterues i 95.1% (nentedhjete e pese pike nje perqind) te aksioneve te kesaj.
2. **Dervish Haskaj**, zoterues i 4.9 % (kater pike nente per qind) te aksioneve te kesaj shoqerie.

Me vendimin numer 65, date 30.03.2007 te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve eshte miratuar shitja e aksioneve ne pronesi te Dervish Haskaj dhe blerjen e tyre nga aksioneri i po kesaj shoqerie Dritan Celaj.

Dervish Haskaj deklaroi me vullnetin e lire dhe te plote se bazuar ne te drejten qe buron prej aksioneve, ia shet keto aksione zotit **Dritan Celaj** duke i transferuar ne kete menyre paketen totale te aksioneve perfaqesuar nga 4.9 % (kater pike nente perqind) e barabarte me 1470 (njemije e katerqind e shtatedhjete) aksione, kundrejt cmimit te shitjes prej, 13.000.000

(trembedhjetë milion) leke, duke ja kaluar në pronësi dhe zotërim të plotë bërësit Dritan Celaj.

Per shumen prej 13.000.000 (trembedhjetë milion) leke, bërësi deklaron se e ka kryer pagesën në llogarinë bankare të shitësit me numër 70059 Banka Credins duke paraqitur edhe urdher pagesën në datë 30.03.2007. Kjo shumë i përgjigjet vlerës së aksioneve të transferuar dhe së shitësi pranon se i ka marrë këto leke nga bërësi.

Pas nënshkrimit të kësaj kontrate shitësi Dervish Haskaj pranon dhe deklaron se heq dorë nga çdo titull dhe e drejtë lidhur e zotërimit të aksioneve të lartpërmendur dhe e njeh dhe emëron bërësin Dritan Celaj si të vetmin pronar dhe zotëruar të atyre aksioneve dhe ai tani është i lirë të veprojë konform ligjit. Shitësi deklaron se nuk ka asnjë pretendim edhe ndaj shoqërisë në lidhje me të ardhurat që janë fituar për shkak të zotërimit të aksioneve.

Shitësi deklaron se Shoqëria "Atlantik"sha ka përmbushur të gjitha detyrimet financiare ndaj tij që rrjedhin nga zotërimi i aksioneve si edhe nga funksioni i z. Dervish Haskaj si anëtarë i Këshillit Mbikqyres të Shoqërisë "Atlantik"sha si edhe çdo detyrim tjetër financiar. Shitësi heq dorë nga të gjitha pretendimet financiare ndaj Shoqërisë "Atlantik"sha.

Shitësi nëpërmjet këtij dokumenti, kontrate shitje aksionesh garanton se :

1. Të gjitha aksionet e lartpërmendur të Shoqërisë tregtare "Atlantik"sha të zotëruara prej tij dhe të transferuara tek bërësi Dritan Celaj janë të lira nga çdo barrë, peng, huamarrje, konfiskim, pretendim personash të tretë apo dyshime, gjithashtu garanton se aksionet janë të lira nga çdo detyrim ligjor.
2. Të gjitha aksionet e lartpërmendur të Shoqërisë, janë shpallur dhe nënshkruar konform ligjit dhe vlerat e tyre janë reale dhe të kontrollueshme.

Kapitali themelues i kësaj shoqërie në bazë të Vendimit të Gjykatës së rrethit Gjyqësorë Tiranë numër 25720/7, datë 23.09.2005 është 300.000.000 (tre qind milion) Leke dhe pas nënshkrimit të kësaj kontrate shitje mbetet ai që ka është pasqyruar në vendimin e lartpërmendur.

Shoqëria deri me datën e sotme vepron normalisht brenda kuadrit ligjor dhe nuk është objekt ndalimesh apo anulimesh nga Gjykata e rrethit Gjyqësorë Tiranë nga e cila u miratua, bazuar në statut dhe aktin e themelimit.

Shitësi kalon tek bërësi të gjithë paketën prej 4.9 % (kater pike nente per qind) të aksioneve të kapitalit të shoqërisë duke deklaruar se nuk ka asnjë pretendim për përmbushjen e detyrimit nga bërësi dhe Shoqëria.

Pas nënshkrimit të kësaj kontrate Dritan Celaj bëhet pronar (zotëruar) i 100% (njëqind për qind) të aksioneve të kësaj shoqërie dhe shitësi Dervish Haskaj nuk ka më asnjë lloj të drejte mbi aksionet e kësaj shoqërie.

Aksioneri i vetem i shoqerise ne baze te kesaj kontrate mbetet z. Dritan Celaj zoterues ne masen 100 % (nieqind per qind) te aksioneve te kesaj shoqerise e barabarte me 30.000 (tridhjete mije aksione).

Kontrata hartohet ne 5 (pese) kopje te njeita, nga te cilat nje e mbajne palet, nje depozitohet ne Zyren e Rregjistrimit Tregtar, nje kopje depozitohet ne Aktet e Shoqerise dhe nje kopje prane Zyres se Noterit ku edhe ajo u redaktua.

Termat e Kontrates pasi u redaktuan prej meje Noteres iu bene te njohura paleve kontraktuese, te cilat e nenshkruan ate me vullnetin e tyre te lire dhe te plote, ne prezencen time.

PALET

SHITESI

Dimitris Hoxha
[Signature]

BLERESI

Dritan Celaj
[Signature]
ATLANTIK
SHOQ. DREJTORE
TIRANE

NOTER

NOTERE
ARTEMISA MEÇAJ
Rr. Durresit nr 79
TIRANE TEL: 04 258807
TIRANE ALBANIA

